



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety | 02 - 02 | 4 | viti god year |
| Organ /Njesia Organ /Jednitca Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prilog Appendix | Sansa Kolicina Quantity |
| SKAMBHOK | 667/2024 | | 117 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1543/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1543/2023 të datës 20.12.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë pune kundër Vendimit Nr.08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2024, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pahenues ankesa me numër A.nr.1543/2023 e datës 20.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 08/25-1200-2023 i datës 27.11.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 30.01.2023 ka shpall konkursin me Nr. KQZ-06/2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", i cili ka qenë i vazhduar për shtatë (7) ditës deri më datë 27.02.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesi, ku sipas Raportit të datës 07.03.2023 Komisioni Përzgjedhës ka përgatitur listën e ngushtë, nga rrjedhë se sipas këtij raporti nëntë (9) kandidatë kanë plotësuar kushtet e konkursit ndërsa katër (4) kandidat nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 14.03.2023 përmes e-mailit e ka njoftuar ankuesin se i njëjti nuk është përzgjedhur të jetë pjesë e listës së shkurt, gjegjësisht të njëjtit i është refuzuar aplikacioni për shkak se nuk e ka plotësuar kriterin e konkursit të përcaktuar si në pikën dy (2) lidhur me përvojën e punës. Ankuesi kundër njoftimit të datës 14.03.2023 ka parashtruar ankesë me datë 16.03.2023 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë KQZ-së, ndërsa përmes Vendimit Nr.08/27-363-2023 të datës 03.04.2023 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 16.03.2023, kurse ka lënë në fuqi Raportin e datës 07.03.2023 të Komisionit Përzgjedhës lidhur me përfshirjen e kandidatëve në listën e ngushtë, me arsyetimin se ankuesi nuk e ka plotësuar kriterin numër 2 të konkursit lidhur me përvojën e punës, pasi që ankuesi kualifikimin e kërkuar sipas kriterëve të konkursit e kishte fituar sipas Diplomës së datës 13.07.2021 në drejtimin "Programi i Shkencave Politike me Specializim në Administratë Publike" lëshuar nga Kolegji UBT, ndërsa përvoja e punës pas kualifikimit në fushën e kërkuar të kualifikimit nuk ka qenë katër (4) vjet, rrjedhimisht përvoja e punës pas datës 13.07.2021 nuk është katër (4) vite.

Ankuesi me date 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave në KQZ lidhur me refuzimin aplikacionit. Ndërsa me date 07.06.2023 përmes emailit i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilës ka theksuar faktin se i njëjti tërhiqet nga ankesa e parashtruar me date 18.04.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër vendimit Nr.08/27-363-2023 të datës 03.04.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Sipas ankesës me numër A.nr.824/2023, të parashtruar nga ankuesja Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 24.07.2023 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.824/2023 përmes të cilit, e ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.08/27-668-2023 i datës 22.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke anuluar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023, fazën e testimit me gojë dhe me shkrim si dhe Raportin e përgatitjes së listës së ngushtë të datës 07.03.2023, si dhe ka obliguar Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ndër marr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvillojë procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve" në Lipjan, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 21.08.2023 përmes emailit Zyrtar është njoftuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me zbatueshmërinë e vendimit me numër A.nr.824/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e cila nga data 18.08.2023 ka filluar me shqyrtimin e aplikacionit dhe krijimin e listës së ngushtë ku sipas Raportit me numër 08/1012-2023 të datës 05.10.2023 të Kryesuesit të Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën e punës KQZ-06/2023 ankuesit

i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti kualifikimi arsimor i fituar me diplomën e ankuesit të cilën e prezanton me të cilën ka aplikuar me date 06.08.2007 nuk është adekuat dhe nuk përshtatet me kualifikimin e kërkuar në konkursin në fjalë si dhe i njëjti me date 4.07.2021 ka fituar kualifikimin arsimor sipas kriterit nr.1 të konkursit me kualifikim përkatës, mirëpo pas kësaj date aplikuesi nuk e arrin përvojën e punës së kërkuar sipas kriterëve të konkursit dhe se i njëjti nuk ka fituar të drejtën që të hyjë në listën e ngushtë.

I pa kënaqur me Raportit me numër 08/1012-2023 të datës 05.10.2023 te Kryesuesit te Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën e punës KQZ-06/2023, me date 31.10.2023 ankuesi, ka parashtruar ankesë kundër mos përfshirjes në listën e ngushte për pozitën "Zyrtar Komunal i Zgjedhjeve" në Komunën e Lipjanit, te Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa ne Sekretariatit e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve. Ndërsa kjo e fundit përmes vendimit me numër 08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023 ka marr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin me numër 08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023 te Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa ne Sekretariatit e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, me date 20.12.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokolli 7570/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se ankuesit i është mohuar e drejta e nënshtrimit të testit me shkrim në këtë procedurë të rekrutimit pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet e konkursit .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te KQZ, ndërsa me datë 09.01.2024, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1543/2023, e datës 20.12.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e shpallur nga KQZ të datës 31.01.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 02.02.2023; Kërkesën për punësim të datës 02.02.2023; Deklaratën e ankuesit të datës 02.02.2023; Dokumentin e identifikimit te ankuesit; ; Çertifikatën e datës 02.02.2023 lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Diplomën e ankuesit të datës 14.07.2021 me numër:516/45-64; Diplomën e ankuesit të datës 06.08.2007 me numër:217; Akt emërimin e ankuesit të datës 03.03.2012 me shifër: Nr.1-111-255; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 10.01.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 31.12.2021; Çertifikatën e ankuesit e lëshuar nga USAID; Certifikatë e datës 09.10.2015; Certifikatë e datës 09.10.2015; Certifikatë e datës 20.12.2009; Certifikatën e datës 09.09.2012; Certifikatën e datës 21.12.2009; Certifikatë e datës 15.02.2010; Mirënjohjen e datës 31.12.2014; Vërtetimin e datës 07.11.2023; Njoftimin e datës 10.06.2023 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të KQZ-së; Ankesën e ankuesit të datës 17.10.2023; Vendimin Nr.08/1200-2023 të datës 27.11.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër A.nr.652/2023 të datës 12.06.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.12.2023; Përgjigjen ne ankesë te datës 09.01.2023; Regjistrin e aplikacioneve te pranuar; Raportin nga Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës se ngushte për pozitën KQZ-06/2023; Vendimin me numër 02-222-2023 të datës 02.03.2023; Vendimin për ndryshim dhe plotësim te vendimit me nr.02-222/2023 të datës 02.03.2023 pe zëvendësimin e anëtares se komisionit përzgjedhës për pozitën me numër reference KQZ 062023; Ankesën me numër 03/1105-2023 te datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesi ne Komisionin për ankesa ne QKQZ; Vërtetimin me Nr.02/2023 të datës 15.03.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes konkursit të datës 31.01.2023 ka shpallur konkursin publik për gjashtë (6) pozita të lira, prej tyre edhe pozitën me shifër "KQZ-06/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", ndërsa sipas aplikacionit të datës 02.02.2023 konstatohet se në këtë konkurs për pozitën e lartcekur ka aplikuar edhe kandidati tani e tutje në cilësi të ankuesit.

Po ashtu, nga përmbajtja e Konkursit të datës 31.01.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan" kriteret e përcaktuara lidhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e punës kanë qenë: "1. Të ketë diplomë universiteti në lëminë e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkencave sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose statistikë; dhe 2. Së paku katër (4) vite përvojë pune".

Sipas Raportit me numër 08/1012-2023 të datës 05.10.2023 të Kryesuesit të Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushte për pozitën e punës KQZ-06/2023 ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti kualifikimi arsimor i fituar me diplomën e ankuesit të cilën e prezanton me të cilën ka aplikuar me date 06.08.2007 nuk është adekuat dhe nuk përshtatet me kualifikimin e kërkuar në konkursin në fjale si dhe i njëjti me date 4.07.2021 ka fituar kualifikimin arsimor sipas kriterit nr.1 të konkursit me kualifikim përkatës, mirëpo pas kësaj date aplikuesi nuk e arrin përvojën e punës së kërkuar sipas kriterëve të konkursit dhe se i njëjti nuk ka fituar të drejtën që të hyjë në listën e ngushtë.

I pa kënaqur me Raportit me numër 08/1012-2023 të datës 05.10.2023 të Kryesuesit të Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën e punës KQZ-06/2023, me date 31.10.2023 ankuesi, ka parashtruar ankesë kundër mos përfshirjes në listën e ngushte për pozitën "Zyrtar Komunal i Zgjedhjeve" në Komunën e Lipjanit, të Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa kjo e fundit përmes vendimit me numër 08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023 ka marr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me numër 08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023 të Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ankuesi me date 20.12.2023, ka parashtruar ankesën me numër protokollit 7570/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore se ankuesit i është mohuar e drejta e nënshtrimit të testit me shkrim në këtë procedurë të rekrutimit pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet e konkursit .

Duke marr parasysh dispozitat të aplikuara ligjore në fuqi duke përfshirë edhe aktet e brendshme normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegji i Këshillit duke mbështetur në

Aktgjykimin në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të datës 09.07.2020 me Nr.ref.:AGJ 1583/20, dhe në kuptim të normave të brendshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ndërliidhen me procedurat e rekrutimit, ju referua Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më konkretisht nenit 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, ku përcaktohet se: *“Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet ne baze te kritereve ne vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional i dokumentuar, që konsiston ne vlerësimin e jetëshkrinit te kandidatëve dhe dëshmitë e ofruara për shkollim dhe kualifikime dhe përvojën, vlerësimin e arsimimit dhe vlerësimin e trajnimeve, te lidhura me fushën përkatëse te përgjegjësiëve. 1.2 Përvoja e punës, që konsiston ne eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale, varësisht nga pozita e klasifikuar e punës”*. Bazuar në këtë rregullore, Kolegji i Këshillit, konstaton se lidhur më përvojën e punës për pozitën përkatëse në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, aplikohet sistemi i përvojës së punës profesionale apo menaxheriale dhe kjo varësisht nga shpallja e pozitës dhe nivelit të saj, që në këtë rast pozita *“Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve”* është pozitë e nivelit profesional, mbi këtë bazë edhe përvoja e punës duhet të jetë profesionale.

Andaj Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i themeluar sipas Vendimit me Nr. 02-222/2023 të datës 02.03.2023 dhe i ndryshuar dhe plotësuar sipas vendimit 02/222/A-2023, më datë 05.10.2023 ka përgatitur Raportin lidhur me listën e ngushtë, duke konstatuar se nga trembëdhjetë (13) kandidatë, gjashtë (6) prej tyre janë përfshirë në listën e ngushtë ndërsa shtatë (7) nuk janë përfshirë në listën e ngushtë. Ndërsa kandidati M.M respektivisht ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për shkak se sipas komisionit, *kualifikimi arsimor i kërkuar me konkurs nuk përshatet me arsimimin e fituar me diplomën e tij të prezantuar më të cilën ka diplomuar aplikuesi më datë 06.08.2007, kurse më datë 14.07.2021 ka fituar kualifikimin arsimor sipas kriterit të konkursi mirëpo pas kësaj datë aplikuesi nuk arrin përvojën e punës së kërkuar*. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson faktin se Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë ka vepruar në kuptim të kritereve të rregullores, duke dhënë sqarime konkrete për kandidatët që nuk janë hyrë në listën e shkurtër.

Përkitazi me këtë, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe duke u bazuar në Diplomën Nr.516/45-64 6 të lëshuar me datë 14.07.2021 nga „Kolegji UBT”, ka konstatuar se ankuesi ka përfunduar studimet ne programin Shkenca Politike me specializim ne Administrate Publike me datë 13.07.2021, dhe si rrjedhojë i njëjti nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës se punës profesionale prej katër (4) viteve siç kërkohet në konkurs sepse pozita *“Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve”* është pozitë e nivelit profesional, dhe mbi këtë bazë edhe përvoja e punës duhet të jetë profesionale, sepse përvojë profesionale njihet përvoja e fituar pas diplomimit në njërën prej fushave respektive të përcaktuara në konkurs (në lëmine e *Drejtësisë, Ekonomisë, Administratës Publike, Shkencave Politike, të Drejtave Të Njeriut, Administrim të Zgjedhjeve, Shkenca Sociale, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Menaxhment Ose Statistikë*). Njohja e përvojës se punës profesionale vetëm pas diplomimit në fushën përkatëse është konfirmuar edhe me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës se Kosovës. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në kuadër të Sekretariatit të Komisionit Qendror te Zgjedhjeve me rastin e përgatitjes se listës se ngushtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve

në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përkatësisht me nenin 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2 ku përcaktohet se: „Anëtarët e Komisionit Përzgjedhës vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional i dokumentuar, që konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit të kandidateve dhe dëshmitë e ofruara për shkollim dhe kualifikime dhe përvojën, vlerësimin e arsimimit dhe vlerësimin e trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse të përgjegjësi. 1.2 Përvoja e punës, që konsiston në eksperiencën përkatëse profesionale dhe menaxheriale, varësisht nga pozita e klasifikuar e punës; 1.3 Elementet e tjera të meritës të cilat lidhen me vendin relevant të punës. 2. Secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është: arsimimi 20 pikë, arsimimi dhe kualifikimet profesionale 20 pikë, përvoja e punës 20 pikë, shkathtësia dhe aftësitë, 20 pikë dhe elementet tjera të meritës 20 pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve për përfshirje në listën e ngushte është 80, të cilat ndahen përkatësisht, ndërsa numri i aplikantëve të cilët mund të jenë të përfshirur në procedurat e mëtejme të testimit është 40 pikë. Vlerësimi bëhet duke u bazuar në kriteret e konkursit dhe dokumentacionin e ofruar nga aplikantët. 3. Kandidatet, të cilët nuk plotësojnë kriteret minimale të arsimimit, kualifikimit dhe përvojes se punës, nuk përfshihen në listën e ngushte të rekrutimit.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, lidhur me përvojën e punës, Kolegji i Këshillit duke mbështetur në Aktgjykimin në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të datës 09.07.2020 me Nr.ref.:AGJ 1583/20, konstatoi se procedura e rekrutimit sipas konkursit me Nr.KQZ-06/2023 për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve” në Lipjan të shpallur nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deri në fazën e përgatitjes së listës së ngushtë, rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit deri në këto faze është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve*” dhe dispozitave të Rregullores Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuase të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Nga konstatimet si më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe nxjerrjes së Vendimit Nr.08/25-1200-2023 të datës 27.11.2023, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Udhëzimin Administrativ (KQZ) Nr.02/2018 për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1543/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.